



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Datë/a:	
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Fitore Pacolli: shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	Arianit Mustafa: drejtor i Njesisë së auditimit të brendshëm
Tema/ Subjekat/Subject:	Raporti i punës 1.1.2016 deri me 31.3.2016

RAPORTI I PUNËS

Gjatë periudhës raportuese (1.1.2016 - 31.3.2016), Njësia e auditimit të brendshëm ka vazhduar me auditimin e prokurimit për vitin 2015. Gjatë kësaj periudhe stafi i NJAB-së ka marrë pjesë në punëtorinë dyditore të organizuar nga Zyra zvicrane HELVETAS, "Swiss Intercooperation", me temën "Auditimi, prokurimi dhe roli i Kuvendit të Komunës", të mbajtur më 22 dhe 23 mars 2016 në hotel "Emerald" në Prishtinë, si dhe konferencën përmbyllëse të projektit PIFC, më 30 mars 2016, të mbajtur në hotel "Sirius". Kemi realizuar obligimet raportuese ndaj NJQH - AB Ministria e Financave, si dhe kemi pasur komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët e OSBE-së.

NJAB-ja përballet edhe me sfida, të cilat po e pengojnë punën e Njesisë, siç janë: mungesa e miratimit të planeve strategjike 2016 - 2018 dhe planit vjetor 2016, nga ana e Komitetit të auditimit, mungesa e komunikimit me anëtarët e Komitetit të auditimit, përkundër disa përpjekjeve të bëra, por edhe mosplotësimi i Njesisë së auditimit me stafin e nevojshëm.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1